

# Përmbledhje



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## **GJYQTARI I GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR, Z. ARBËR ÇELA JEP SHPJEGIME PARA KPK MBI TË DHËNAT E KONSTATUARA PAS VLERËSIMIT TË KRITERIT TË PASURISË DHE ATIJ TË FIGURËS**

**RAPORTIM PARAPRAK I SEANCËS DËGJIMORE  
DATË 02/12/2022 PRANË KPK:**

Proçesi i rivlerësimit për subjektin është realizuar bazuar në të tre kriteret: kriteri i pasurisë, kriteri i kontrollit të figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.,

Kriteri i pasurisë: ILDKPKI paraqiti raport me bilanc negativ,

Kontrolli i figurës: DSIK ka paraqitur raport përfundimtar të rishikuar, pjesërisht të deklasifikuar, ku nga shqyrtimi i 8 dosjeve gjyqësore janë krijuar indicie dyshuese mbi vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, në kushtet e favorizimit apo të korrupsionit

Vlerësimi i aftësive profesionale: KLGJ ka depozituar raport pozitiv, mbi vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit, ndërkohë publiku kishte depozituar 7 denoncime pranë KPK



***Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, z. Arbër Çela jep shpjegime para KPK mbi të dhënat e konstatuara pas vlerësimit të kriterit të pasurisë dhe atij të figurës***

Më datë 2 Dhjetor 2022, ora 10:00, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK), u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit Z. Arbër Çela, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.

Trupi gjykues përbëhej nga z. Lulzim Hamitaj (*kryesues*), znj. Valbona Sanxhaktari (*relatore*) dhe znj. Genta Tafa Bungo (*anëtare*), si dhe u asistua nga vëzhguesi ndërkombëtar z. Gerrit Sprenger në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

Kryesuesi i trupës gjykuese kërkoi largimin nga salla të një përfaqësuesi mediatik, i cili po regjistronte audio-vizualisht seancën dëgjimore, në kundërshtim me referimin verbal të realizuar nga trupa gjykuese, bazuar në pikën 3) të Rregullores për Mediat të KPK.

Hetimi administrativ mbi subjektin e rivlerësimit nga ana e KPK-së rezultoi se ka përfunduar për të tre kriteret, atë të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, bazuar në pikën 2 të nenit 4, të Ligjit Nr. 84/2016.

Subjekti i rivlerësimit kishte zgjedhur të paraqitej pa praninë e një përfaqësuesi ligjor, nuk paraqiti kërkesa paraprake apo procedurale në lidhje me hetimin ose trupën gjykuese. Seanca u shoqërua me diskutime proaktive e ndërhyrje, ndërmjet trupës gjykuese dhe subjektit të rivlerësimit.

Gjatë vlerësimit të kriterit të pasurisë, raporti me bilanc negativ i hartuar nga ILDKPKI, nxiti diskutime nga ana e trupës gjykuese dhe subjektit të rivlerësimit. Pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit tjetër bashkëpronar mbi pasurinë e paluajtshme dhe atë të luajtshme, u kundërshtuan nga ana e subjektit të rivlerësimit, nën pretendimin se përllogaritja nuk është realizuar në mënyrë korrekte, ndërkohë që bashkëpronari nuk duhej të konsiderohej ‘person i lidhur’ në kuptim të nenit 3, pika 13 të ligjit nr. 84/2016. Shlyerja e detyrimit të huasë nga një person i tretë në favor të subjektit të rivlerësimit, tërhoqi vëmendjen e vëzhguesit ndërkombëtar. Subjekti kundërshtoi gjetjet e hetimit administrativ të Komisionit, i cili konstatoi pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare të subjektit për të shlyer detyrimin.

DSIK ka paraqitur raport përfundimtar të rishikuar, pjesërisht të deklasifikuar, sipas të cilit konkludohej se nga shqyrtimi i 8 dosjeve gjyqësore janë krijuar indicie dyshuese mbi vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, në kushtet e favorizimit apo të korrupsionit. Nuk u evidentuan kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të dyshuar si të përfshirë në krimin e organizuar.

KLGIJ ka depozituar raport pozitiv, mbi vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit, ndërkohë publiku kishte depozituar 7 denoncime pranë KPK. 2 ankesa të tjera për zvarritje të gjykimin janë depozituar më herët ndaj subjektit, për të cilat ish-KLD kishte vendosur masën disiplinore “tërheqja e vëmendjes me shkrim” dhe një denoncim publik në media lidhur me një çështje ku subjekti rezultoi të ketë qenë kryesues i një trupe gjykuese që ka pranuar gjykimin e shkurtuar për një të pandehur për vrasje.

Komisioni vendosi shpalljen e vendimit më dt. 7 Dhjetor 2022, ora 09:45.